

Pyetje: Çfarë sëmundje janë fruthi dhe rubella?

Përgjigje: Fruthi është sëmundje shumë serioze ngjitëse e cila shkaktohet nga virusi i fruthit. Fruthi mund të komplikohet me pneumoni, verbim, encefalit (infeksion të trurit), diarre të rëndë me dehidrim si dhe infeksion të veshit. Fruthi përhapet përmes spërklave nga hunda, goja ose fyti i personave të infektuar.

Fruthi është njëra prej shkaqeve kryesore të vdekjes tek fëmijët në botë.

Rubella është sëmundje relativisht e lehtë por nëse nëna infektohet gjatë shtatzënisë atëherë mund të shkaktojë deformitet tek fryti gjatë jetës intrauterine ose të shkaktojë abort.

Pyetje: Pse fruthi dhe rubella janë në axhendën e OBSH-së dhe në atë të shëndetit publik?

Përgjigje: Pas një periudhe me numër shumë të ulët të rasteve me fruth në Rajonin Evropian të OBSH-së gjatë vitit 2021, nga fillimi i vitit 2022 rastet kanë filluar të rriten pasi që sfidat e vazhdueshme në programin e vaksinimit gjatë pandemisë COVID-19 kanë lënë shumë persona të pavaksinuar mes të cilëve një numër të madh të fëmijëve tek të cilët sëmundja mund të jetë fatale.

Pas shpërthimeve të mëdha të fruthit përgjatë vitit 2018 dhe 2019 ku janë raportuar përafësisht 200 000 raste, ku numri i rasteve të raportuara të fruthit në Rajonin Evropian të OBSH-së në vitin 2020 ka rënë në 12 000. Gjatë vitit 2021 u raportuan vetëm 159 raste të fruthit në 22 vende; megjithatë, ky numër u rrit në vitin 2022 në 904 raste të raportuara deri më sot.

Në Kosovë nuk është regjistruar asnjë rast i fruthit nga viti 2000 deri në vitin 2017. Gjatë viteve 2017-2018 janë regjistruar 749 raste të konfirmuara dhe dy raste të vdekjes nga fruthi. Këto raste dhe vdekje do të mund të ishin parandaluar nëse do të ishin të vaksinuar.

Pyetje: Fruthi nuk është më i zakonshëm. A nevojitet ende vaksinimi?

Përgjigje: Numri i rasteve të fruthit kanë rënë në mënyrë drastike gjatë viteve të fundit falë futjes së dy dozave të vaksinës në kalendarin rutinore të imunizimit në të gjithë Rajonin e Evropës. Megjithatë, ende vazhdojnë të paraqiten epidemi të fruthit në vende ku mbulueshmëria me vaksinim është me e ulët. Mbulueshmëria mbi 95% me vaksinim kundër fruthit nevojitet për të mbrojtur popullatën nga fruthi ku përfshihen edhe ata që nuk mund të vaksinohen për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

Pyetje: A ka ndonjë dëshmi që vaksinimi shkakton autizëm?

Përgjigje: Jo! Vaksinimi mbron të gjitha moshat nga kjo sëmundje. Vakcina e fruthit është në përdorim për më shumë se 50 vjet. Është e sigurt, efektive dhe nuk kushton shtrenjtë. Vaksinat kundër fruthit, shytave dhe rubellës (MMR) janë të sigurta dhe shumë efektive sa që me mbulueshmëri të lartë me imunizim mund të eliminojmë këto sëmundje nga i gjithë Rajoni Evropian.

Duke ju falenderuar vaksinave prindërit e fëmijëve të cilët janë vaksinuar plotësisht nuk duhet të shqetësohen nga sëmundjet e rënda si difteria, tetanusi, poliomieliti, fruthi dhe rubella. Duhet të bëjmë çdo përpjekje të ofrojmë informata të bazuara në prova mbi përfitimet e vaksinimit të cilat

FAKTE BAZIKE QË SHPËTOJNË JETË FRUTHI DHE RUBELLA



duhet ti paraqesim në mënyrë që ti kuptoj publiku. Këto informata duhet të vijnë nga burime të besueshme dhe të shpërndahen përmes gjitha kanaleve mediatike.

Duke e vaksinuar fëmijën tuaj ose veten ju do të mbronit fëmijët, familjen, komunitetin dhe vendin tuaj nga fruthi dhe rubella si dhe do të kontribuoni në eliminimin global të fruthit në mbarë botën.

Pyetje: Por, kam lexuar se ka prova që vakcina MMR shkakton autizëm?

Përgjigje: Autizmi paraqet shqetësim të madh për shëndetin publik prandaj nevojitet të kuptojmë më mirë shkaqet e tij. Shumë studime të ndërmarra në mënyrë strikte ku janë përfshirë qindra mijëra fëmijë me qëllim që të hulumtohet nëse ka lidhje të mundshme mes vaksinës MMR dhe autizmit ose çrregullimeve autike, përfundimisht nuk ka gjetë lidhje të tillë. Në vitin 2002, Komiteti Global Këshillimor për Sigurinë e Vaksinave bëri një rishikim të gjerë të njëmbëdhjetë studimeve epidemiologjike (duke përfshirë këtu studimin e bazuar në popullatë në Danimarkë me mbi 500,000 fëmijë të cilët përfaqësojnë pothuajse 100% të fëmijëve të lindur gjatë asaj periudhe) dhe arriti në përfundim se nuk ekziston asnjë provë për ndonjë lidhje mes vaksinës së MMR dhe autizmit ose çrregullimeve autike. Ky studim mund të gjendet në <http://www.nejm.org/doi/full/10.1056/NEJMoa021134>

Pyetje: Po me sëmundjet tjera?

Përgjigje: Garantimi i sigurisë dhe cilësisë së vaksinave është njëra nga prioritetet kryesore të OBSH-së. Para se të mund të licencohet çdo vaksinë vlerësohet dhe testohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për t'u siguruar se është e sigurt dhe efikase. Çdo grup i vaksinave kontrollohet veçmas para se të përdoret dhe monitorimi i tyre për efekte anësore është një proces i vazhdueshëm që zhvillohet si në nivelin lokal por edhe në atë global. Reaksionet e zakonshme, si skuqja dhe dhimbja në vendin e injektimit janë të vogla dhe të përkohshme. Efektet serioze shëndetësore pas vaksinimit janë të rralla por tërësisht të hulumtuara. Nëse EPPV dyshohet se ka ndonjë ndërlidhje me vaksinimin atëherë ndërmerren hapa të menjëhershëm për të adresuar shkakun. Në shumicën dërrmuese të rasteve këto rezultojnë të jenë të rastësishme gjatë vaksinimit (që ndodh në të njëjtën kohë por nuk ndërlidhen me vaksinën).

Pyetje: Edhe pse ka studime të shumta hulumtuese që vërtetojnë se vaksinimi nuk shkakton sëmundje, shumë persona besojnë se po. Pse ndodh kjo dhe si mund ta parandalojmë këtë?

Përgjigje: Vaksinimi është metoda më efikase e shëndetit publik që kemi në dispozicion për promovimin e shëndetit dhe uljen e barrës së sëmundjeve infektive. Duke ju falenderuar vaksinimit, lija (variolla), e cila dikur vriste 35% të infektuarve ose shkaktonte verbim si dhe pasoja të tjera është eradikuar globalisht. Polio, e cila është sëmundje që shkakton paralizë është ende endemike vetëm në tri vende. Fruthi dhe rubella janë eliminuar nga i gjithë rajoni i OBSH-së në Amerikë dhe rrallë hasen në Evropë në vendet me mbulueshmëri të lartë me vaksinim. Rreziqet serioze shëndetësore që ato paraqesin për fëmijët dhe të rriturit e pavaksinuar pothuajse janë harruar.

Trajtimi i hezitimit për vaksinim është thelbësor jo vetëm për vaksinim në afat të shkurtër, por edhe për sigurimin e qëndrueshmërisë së popullatës ndaj thashethemeve dhe dezinformatave në të ardhmen.

Pyetje: A është e rrezikshme t'u jepen fëmijëve vakcina të kombinuara si MMR (kundër fruthit, shytave dhe rubellës)?

Përgjigje: Provat shkencore tregojnë se administrimi i disa vaksinave në të njëjtën kohë nuk ka asnjë efekt negativ në sistemin imunitar të fëmijës. Në fakt, vetëm përmes frymëmarrjes dhe ngrënies fëmijët ekspozohen çdo ditë ndaj disa qindra substancave të huaja që shkaktojnë përgjigje imune. Vaksinat e kombinuara rekomandohen meqenëse ato mundësojnë: kursimin e kohës dhe mjeteve (parave); vizita më të rralla në institucionet e kujdesit shëndetësorë; zvogëlon shqetësimin për fëmijën me më pak shpime; rrisin probabilitetin që fëmija të vaksinohet plotësisht sipas kalendarit të rregullt.

Pyetje: Çka nevojitet për të eliminuar fruthin dhe rubellën?

Përgjigje: Për të eliminuar një sëmundje kërkohet imunitet i lartë i popullatës ndaj asaj sëmundje. Mbulueshmëria me vaksinim në pupullatë duhet të jetë mbi 95% me dy doza të vaksinës kundër fruthit-shytave-rubellës (MMR). Aty ku shkalla e vaksinimit është më e ulët se 95%, numri i personave të pambrojtur rritet me kalimin e kohës, duke e lënë komunitetin gjithnjë e më shumë në rrezik nga shpërthimet në shkallë të gjerë.

Eliminimi gjithashtu kërkon sistem të mbikëqyrjes me cilësi të lartë, që të zbulohen rastet e dyshuara sa më herët dhe të verifikohen me teste laboratorike. Në këtë mënyrë rastet e dyshuara mund të konfirmohen me qëllim që masat e kontrollit mund të nisin shumë shpejt. Testet specifike laboratorike gjithashtu lejojnë identifikimin dhe karakteristikat e transmetimit të sëmundjes brenda dhe jashtë vendeve.

Pyetje: Cilat janë sfidat kryesore për eliminimin e fruthit dhe rubellës?

Përgjigje: Njëra nga sfidat kryesore është arritja dhe ruajtja e mbulueshmërisë së lartë të popullatës me vaksinim me së paku 95% me dy doza të vaksinës.

Derisa shumica e prindërve i vaksinonjë fëmijët e tyre, disa të tjerë vendosin që të shtyjnë vaksinimin ose edhe madje të mos i vaksinonjë ata fare. Mos vaksinimi i fëmijëve të tyre i vendos ata në rrezikshmëri të lartë për t'u prekur nga fruthi në moshën kur ata janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj komplikimeve serioze të sëmundjes.

Nëse femrat në moshën e lindjes mbeten të pavaksinuara dhe infektohen nga rubella gjatë shtatzënisë, ato mund të abortojnë ose foshnjat e tyre mund të zhvillojnë deformime të rënda kongjenitale si humbje të dëgjimit, verbëri dhe defekte të zemrës.

Sfidë tjetër është që mbikëqyrja e këtyre sëmundjeve të bëhet mjaft mire me qëllim për të siguruar se rastet e dyshimta të raportohen dhe mostrat e mbledhura të testohen në laboratore kompetente. Pasi që këto sëmundje janë bërë më pak të zakonshme, punëtorët shëndetësorë janë më pak të njohur me karakteristikat e tyre klinike.

Zbulimi i vonshëm i rasteve e rrit rrezikun e përhapjes dhe e vonon fillimin e masave të shëndetit publik për të kontrolluar shpërthimin (siç është hetimi i kontakteve për vaksinim të mundshëm).

FAKTE BAZIKE QË SHPËTOJNË JETË FRUTHI DHE RUBELLA



Pyetje: A duhet të shqetësohen personat që udhëtojnë në Evropë ose jetojnë në rajon për shpërthime të mundshme të fruthit? Çka mund të bëjnë ata për të shmangur virusin?

Përgjigje: Duke qenë se fruthi mbetet endemik në shumicën e pjesëve të botës, ai mund të përhapet kudo, duke përfshirë edhe vendet ku është eliminuar. Çdo person i rrezikuar duhet të marrë dy doza të vaksinës së fruthit në mënyrë që të jetë i imunizuar plotësisht.

Në Rajonin Evropian, dy të tretat nga 53 vendet, territoret dhe zonat e kanë ndërprerë transmetimin endemik të fruthit. Megjithatë, mënyra e sotme e udhëtimit e vënë në rrezik çdo person apo vend, territor apo zonë për mundësinë e infektimit me virusin e fruthit. Shpërthimet do të vazhdojnë në Evropë, si kudo tjetër, derisa çdo komunitet të arrijë nivelin e imunizimit të nevojshëm për të mbrojtur plotësisht popullsinë e tyre.

Autoritetet shëndetësore duhet të maksimizojnë përpjekjet e tyre për të arritur dhe/ose mbajtur të paktën 95% të mbulueshmërisë me 2 doza të vaksinës MMR për të parandaluar qarkullimin në rast të importit.

Pyetje: Çka duhet të bëjmë ne të gjithë në mënyrë individuale dhe kolektive?

Përgjigje: Për të arritur eliminimin rajonal të fruthit dhe rubellës ne duhet të tregojmë përkushtim ndaj eliminimit duke ndërmarrë më shumë veprime për:

- të arritur $\geq 95\%$ mbulueshmëri të imunizimit me dy doza të fruthit dhe të paktën një dozë të vaksinës kundër rubellës;
- të mbyllur boshllëqet e imunitetit në të gjitha grupmoshat;
- zbulimin e hershëm të rasteve dhe shpërthimeve të dyshuara përmes mbikëqyrjes;
- t'u siguruar profesionistëve shëndetësorë dhe publikut informata të mirëfilltë mbi përfitimet dhe rreziqet që ndërlidhen me vaksinimin kundër fruthit dhe rubellës;
- të sigurojë që programet e imunizimit të kenë qasje të qëndrueshme në financim të planifikuar dhe furnizim me cilësi të lartë.

Pyetje: Ku mund të gjej më shumë informata?

Përgjigje: Mund ti gjeni në linqet më poshtë:

Webfaqja e OBSH-së për fruthin: <https://www.who.int/health-topics/measles#>

Webfaqja e OBSH-së për rubellën: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/rubella>

Video e OBSH-së rreth 5 gjërave që duhet të dini për fruthin: <https://www.who.int/health-topics/measles#>